

FINANCA

BULETINI MUJOR | SHTATOR 2025



stabilitetin makroekonomik të Shqipërisë dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë përballë sfidave globale. Agjencia thekson se disiplina fiskale e Shqipërisë dhe rezervat valutore të forta mbështesin stabilitetin makroekonomik të vendit. S&P vlerëson se perspektivat e rritjes ekonomike mbeten rezistente, të mbështetura nga investimet private dhe procesi i

STANDARD&POOR’S RIKONFIRMON VLERËSIMIN E SHQIPËRISË NË “BB” DHE PERSPEKTIVË “TË QËNDRUESHME”

Agjencia e vlerësimit të kreditit “Standard & Poor’s Global Ratings” ka rikonfirmuar vlerësimin afatgjatë të kreditit sovran të Shqipërisë në “BB”, duke konfirmuar gjithashtu një perspektivë “të qëndrueshme”. Ky vlerësim pasqyron besimin e fortë të agjencisë për

anëtarësimin në BE. S&P vlerëson politikën e kujdesshme fiskale që pritet të ndjekë qeveria pas zgjedhjeve parlamentare. Agjencia parashikon që deficitin e qeverisë së përgjithshme të jetë mesatarisht rreth 2% e PBB-së deri në vitin 2028, duke mbajtur borxhin publik të qëndrueshëm dhe në një trajektore graduale rënëse në rreth 51% të PBB-së në vitin 2028. Kjo qasje e matur fiskale, së bashku me rritjen ekonomike, do të sigurojë stabilitetin e financave publike. Në aspektin e rritjes ekonomike, S&P parashikon një zgjerim të PBB-së reale me rreth 3.6% në vitin 2025, të nxitur nga shpenzimet e qëndrueshme të familjeve që mbështeten nga rritja e pagave reale.

► LEXO MË SHUMË

MINISTRIA E FINANCAVE HEDH PËR KONSULTIM PUBLIK STRATEGJINË AFATMESME TË MENAXHIMIT TË BORXHIT 2025–2029

Ministria e Financave ka publikuar në Regjistrin për Konsultim Publik projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit 2025–2029”, një dokument strategjik që përcakton drejtimet kryesore për menaxhimin e borxhit shtetëror dhe financimin e deficitit buxhetor gjatë periudhës 2025–2029. Strategjia synon të sigurojë një menaxhim të qëndrueshëm të borxhit, duke vendosur objektiva të qarta dhe të matshme për përmbushjen e nevojave për financim në periudhën afatmesme, optimizimin e kostove të shërbimit të borxhit, reduktimin e ekspozimit ndaj risqeve dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të

titujve shtetërorë. Dokumenti synon të rrisë transparencën dhe parashikueshmërinë për investitorët dhe palët e interesuara, ndërsa përfaqëson një vazhdimësi të Strategjisë aktuale në fuqi, por me tregues të përditësuar për të reflektuar zhvillimet e fundit në tregun vendas dhe atë të huaj. Parashikohet përmirësimi i indikatorëve të riskut, sidomos në portofolin e borxhit të brendshëm, si dhe mbajtja nën kontroll e ekspozimit ndaj riskut të kursit të këmbimit. Një nga risitë kryesore të kësaj strategjie është prezantimi për herë të parë i Obligacioneve për Individë, të cilat do të krijojnë mundësi të reja investimi për qytetarët, do të diversifikojnë bazën e investitorëve dhe do të kontribuojnë në nxitjen e kulturës së kursimeve.

► LEXO MË SHUMË



NËNSHKRUHET NË PARIS “KONVENTA SHUMËPALËSHE PËR LEHTËSIMIN E ZBATIMIT TË SHTYLLËS SË DYTË SUBJEKT I RREGULLIT TATIMOR”

Ministri i Financave nënshkroi në Paris me Zëvendëssekretaren e Përgjithshme të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) znj. Fabrizia Lapecorella, “Konventën Shumëpalëshe për Lehtësimin e Zbatimit të Shtyllës së Dytë Subjekt i Rregullit Tatimor” (STTR MLI). Nënshkrimi i kësaj Konvente është pjesë e masave, në kuadër të projektit ndërkombëtar BEPS, pjesë e të cilës Shqipëria është që prej vitit 2019. STTR është një pjesë integrale e konsensusit të arritur nga Kuadri Gjithëpërfshirës i Projektit Ndërkombëtar BEPS, për Shtyllën e Dytë të zgjidhjeve (Pillar 2) mbi rregullat globale kundër erozionit të bazës tatimore, që synojnë të adresojnë sfidat tatimore që rrjedhin nga digjitalizimi i ekonomisë. Gjatë fjalës së tij, Ministri Petrit Malaj u shpreh se Shqipëria do të mund të përmbushë me efikasitet më të lartë angazhimet e saj, duke qenë se qëllimi kryesor i Konventës është të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe integritetit të sistemit ndërkombëtar të tatimeve. Ministria e Financave do të vijojë të jetë e angazhuar për të nxitur drejtësinë tatimore, rritjen e të ardhurave, për të parandaluar zhvendosjen e fitimeve, si dhe për garantimin qëndrueshmërisë fiskale, në dobi të një klime më të mirë të të bërit biznes.

► LEXO MË SHUMË

PERFORMANCA PARAPRAKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE PËR JANAR-GUSHT 2025



arritën në rreth 498.6 miliardë lekë, një realizim në masën 101.4 % të planit të periudhës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, u mbledhën rreth 33.9 miliardë lekë më shumë ose 7.3 % më shumë. Në terma vjetorë, të ardhurat totale për 8 mujorin e vitit 2025 u realizuan në masën 65.8 % të planit vjetor.

Të ardhurat e arkëtuara nga Tatimet dhe Doganat, për periudhën

Performanca paraprake e treguesve fiskalë të konsoliduar për periudhën Janar-Gusht 2025 reflekton ecurinë e mbledhjes së të ardhurave dhe realizimit të shpenzimeve.

Të ardhurat totale, për periudhën Janar-Gusht 2025,



KUVENDI MIRATON PROGRAMIN E QEVERISË SË RE “SHQIPËRIA 2030”

Kuvendi i Shqipërisë miratoi në seancë plenare programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, ku z. Petrit Malaj do të jetë Ministër i Financave. Tashmë Shqipëria ka hyrë në një fazë krejt të re të zhvillimi ekonomik, ku

Prodhimi i Brendshëm Bruto arrin në mbi 25 miliardë euro ose 2.5 herë më i lartë në krahasim me vitin 2013, ndërsa borxhi publik është ulur në 54% të PBB-së nga 70.4% që ishte në vitin 2013. Vizioni i programit politik për katër vitet e ardhshme ka në themel një emërues të vetëm, të përbashkët: Shqipëria 2030 – një vend plotësisht i integruar në Bashkimin Evropian; një ekonomi

MINISTRI MALAJ TAKOHET ME NJË GRUP EURODEPUTETËSH, DISKUTOHET MBI PROGRESIN DHE REFORMAT E MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Ministri i Financave priti në një takim një delegacion deputetësh nga Parlamenti Evropian, Komiteti i Kontrollit Buxhetor. Qëllimi i kësaj vizite në vendin tonë është vlerësimi i krijimit të mekanizmave të kontrollit dhe auditimit për Facilitetin për Reforma dhe Rritje, si një instrument i ri i bazuar në performancë i projektuar për të nxitur dhe përmirësuar reformat. Në qendër të bisedimeve mes dy delegacioneve ishte edhe progresi i bërë

në kuadër të reformave që po ndërmerren sa i takon Planit të Rritjes së Ballkanit Perëndimor, i miratuar nga Komisioni Evropian, ku një ndër katër shtyllat ku bazohet është “Rritja e asistencës financiare për mbështetjen e reformave”. Gjatë takimit, Ministri Malaj theksoi rëndësinë e forcimit të kontrollit të brendshëm dhe auditimit, për të garantuar përdorimin e drejtë, transparent dhe efikas të fondeve të Bashkimit Evropian. Një kuadër i qartë për funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm siguron integritet, transparencë dhe



BRUKSEL, ZHVILLOHET TAKIMI I 17-TË I NËNKOMITETIT PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE, FINANCIARE DHE STATISTIKAT BE-SHQIPËRI

Nënkomiteti për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat BE-Shqipëri zhvilloi takimin e 17-të, në Bruksel, takimi i cili shërben si platformë dialogu mbi përparimin e

Shqipërisë në procesin e integrimit. Delegacioni shqiptar kryesohej nga zëvendësministrat e Financave, znj. Erjona Çela dhe z. Andi Memeti. Gjatë diskutimeve, delegacioni shqiptar theksoi, ndër të tjera, rritjen e qëndrueshme fiskale, uljen e papunësisë dhe forcimin e investimeve. Gjithashtu, u vu në pah përmirësimi i klimës së biznesit, menaxhimit të financave publike dhe transparencës fiskale. Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua



Enkuset në përparimin e fondeve të Bashkimit Evropian, ndërsa forcon sistemin për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe korrigjimin e çdo parregullsie, mashtrimi apo korrupsioni.

► LEXO MË SHUMË

mbrojtjes së interesave financiare të BE-së, ku Shqipëria paraqiti hapat e ndërmarrë për forcimin e kontroleve, auditimeve dhe mekanizmave kundër abuzimeve, duke garantuar përdorim më të drejtë dhe efektiv të fondeve evropiane. Mbështetja e BE-së përmes granteve dhe projekteve mbetet thelbësore për reformat strukturore dhe modernizimin e sektorëve strategjikë. Shqipëria konfirmoi angazhimin e saj për transparencë dhe llogaridhënie, duke synuar përmblylljen e negociatave deri në vitin 2027 dhe anëtarësimin e plotë në vitin 2030.

► LEXO MË SHUMË